

URDHËR
Nr. 220, datë 1.4.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 158, DATË 11.3.2020, “PËR
PEZULLIMIN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONEVE TË VLERËSIMIT TË
PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE INVALIDITETIT TË PUNËS”**

Në mbështetje të nenit 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 10107 datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 7 të ligjit nr. 57/2019 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Në pikën 3, të urdhrin nr. 158, datë 11.3.2020, “Për pezullimin e funksionimit të komisioneve të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar dhe invaliditetit të punës”, togfjalëshi “deri në datën 3 prill 2020”, zëvendësohet me togfjalëshin “deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-2019”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**